



Duke u bazuar në nenin 11 dhe nenin 12.2, shkronja d. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 18 të Ligjit nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, si dhe në nenin 5.2 dhe 6 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtarë dhe me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.07.2015, miraton këtë:

V E N D I M

PËR BINJAKËZIMIN E KOMUNËS SË DEÇANIT ME KOMUNËN E ULQINIT TË REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI

I.

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Deçanit, për binjakëzimin e Komunës së Deçanit me Komunën e Ulqinit, të Republikës së Malit të Zi.

II.

Autorizohet Kryetari i Komunës së Deçanit që të fillojë konsultimet me përfaqësuesit e Komunës së Ulqinit, për realizimin e procesit të binjakëzimit.

III.

Kryetari i Komunës së Deçanit duhet të përkujdeset për hartimin e draftit të Marrëveshjes për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar, i cili duhet të përcillet për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal, në Prishtinë.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe me nënshkrimin nga Kryesuesi i Kuvendit.

V.

Vendimi iu dërgohet.

- Kryetarit të Komunës së Deçanit,
- Kryetarit të Komunës së Ulqinit,
- Ministrisë APL,
- Arkivit të Komunës.

01.Nr.VII-2

Deçan, dt.31.07.2015

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj

	HYRËSE-ULAZNA INDOBIR REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DECANI • DEÇANI MUNICIPALITY		
Nga: QK: Froni:	K.K. Deçan - AS	Nr. Prot: Nr. Zëmi: Prot. Nr.:	17294
Nr i faqes: Gr. Stronice: No. Paga:	01	Data: Datum: Date:	04.08.15
DECAN DECANI			